



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. ____/___Prot.

Fier, më 23.12.2022

Lënda: Formulari i njoftimit perfundimtar të fituesit pas ankimit për procedurën me objekt “**Blerje mjet tip autovinç me kosh me lartësi deri 30 m (Automjet zjarrfikës tip autoshtakallë)**”, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

Shtojca 11

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

BASHKIA FIER

Data: 23.12.2022

Drejtuar: Operatorit ekonomik “ALMETA GMBH” SHPK

Adresa: Tirane, Marikaj

NUIS K22013001U

Procedura e prokurimit: E hapur e thjeshtuar, me objekt “**Blerje mjet tip autovinç me kosh me lartësi deri 30 m (Automjet zjarrfikës tip autoshtakallë)**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-49614-11-11-2022**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Blerje mjet tip autovinç me kosh me lartësi deri 30 m (Automjet zjarrfikës tip autoshtakallë)**”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej **4 900 000 (katër milion e nëntëqind mijë) lekë pa TVSH**, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, në perputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [19.12.2022], [Numri .173].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori ekonomik **“ALMETA GMBH” SHPK, me NUIS K22013001U.**
Vlera totale sipas formularit të ofertës është **4 644 444** (katër milion e gjashtëqind e dyzetë e katër mijë e katërqind e dyzetë e katër) **lekë pa TVSH.**
- 2- Operatori ekonomik **“Q.SINAJ” SHPK, me NUIS K82529403A.**
Vlera totale sipas formularit të ofertës është **4 830 000** (katër milion e tetëqind e tridhjetë mijë) **lekë pa TVSH.**

Nga pjesmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

Operatori ekonomik **“Q.SINAJ” SHPK** skualifikohet për arsye se:

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, të operatorit ekonomik **“Q.SINAJ” SHPK, me NUIS K82529403A,** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

- Në Shtojcën 8 “Formulari Përmbledhësi i Vetëdeklarimit (Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik), Pjesa II: “Shkaqet e përjashtimit, A: “DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT”, parashikohet se:

*“Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, **ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.**”*

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikoi deklarimin e operatorit **“Q.SINAJ” SHPK,** në adresën e ueb-it: qkb.gov.al, me organ lëshues: Qendra Kombëtare e Biznesit, dokumentacionin Ekstrak Historik, nga ku rezultoi se Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ka statusin aktiv, **por nuk** ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

- Gjithashtu, Operatori ekonomik në lidhje me kërkesën për sqarime të nevojshme bërë nga KVO në datë 01/12/2022, dërguar me anë të SPE-së, për dokumentacionin e paraqitur në SPE, dok.mjeti; foto mjeti (dokument në gjuhë të huaj), **nuk u përgjigj** brenda afatit të përcaktuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 92 të Ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 82 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik”, i ndryshuar.

Mospërmbushja e kërkesave sipas DST-së përsa më lart përbën shkak për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik **“Q.SINAJ” SHPK.**

* * *

- Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**ALMETA GMBH**” SHPK, me NUIS **K22013001U**, me adresë, Tirane, Marikaj, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **4 644 444** (katër milion e gjashtëqind e dyzetë e katër mijë e katërqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH, dhe prej **5 573 333** (pesë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.
- Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Fier, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.
- Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ZYRTAR I AUTORIZUAR
Zv.Kryetari

Andius OLLDASHI